



British Embassy
Skopje



UK International
Development
Partnership | Progress | Prosperity



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

FINANCIMI POLITIK DHE INTEGRITETI ZGJEDHOR

NË 5 PYETJE TË LEHTA

1 Çfarë është financimi politik?

Përgjigje:

Financimi politik është paraja që përdoret nga partitë politike dhe kandidatët për aktivitetet e tyre dhe për fushatat zgjedhore. Ai përfshin paratë që i marrin dhe shpenzimet që i bëjnë. Financimi politik poashtu i përfshin çështjet si shpërdorimi i burimeve shtetërore dhe blerja e votave.



2 Pse është e rëndësishme transparenca në financimin politik?

Përgjigje:

Transparenca do të thotë të jesh i hapur për mënyrën se si përdoren paratë. Qytetarët duhet të dinë se ata që synojnë të qeverisin vendin nga i sigurojnë paratë dhe si i shpenzojnë ato. Kjo ndihmon në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj partive politike dhe proceseve zgjedhore, si dhe ndihmon në parandalimin e korrupsionit dhe në zhvillimin e zgjedhjeve më transparente dhe më të drejta.



3 Çfarë është një fushatëbërës i palës së tretë?

Përgjigje:

Një fushatëbërës i palës së tretë është një person ose organizatë që shpenzon para për të mbështetur ose kundërshtuar një parti politike apo kandidat gjatë zgjedhjeve, edhe pse nuk është vetë pjesëmarrës në garën zgjedhore.



Shembull:

Një organizatë e shoqërisë civile (OJQ) që shpenzon para për reklama që inkurajojnë qytetarët të votojnë për një kandidat të caktuar.

4 A mund të marrë pjesë një influencer në një fushatë zgjedhore?

Përgjigje:

Po. Një influencer mund të mbështesë një kandidat ose një parti politike. Nëse influenceri paguhet për të promovuar një mesazh politik, kjo pagesë zakonisht duhet të deklarohet si shpenzim i fushatës.



Shembull:

Një YouTuber i njohur merr para për të inkurajuar ndjekësit e tij të votojnë për një parti të caktuar.

5 Çfarë është shpërdorimi i burimeve shtetërore?

Përgjigje:

Shpërdorimi i burimeve shtetërore ndodh kur paratë publike, automjetet qeveritare, zyrat publike ose punonjësit e administratës përdoren për t'i dhënë përparësi një partie politike ose kandidati në zgjedhje. Kjo mund të ndodhë edhe kur qeveritë marrin vendime para zgjedhjeve me qëllim të rritjes së mbështetjes popullore për qeverinë dhe, rrjedhimisht, për partinë ose partitë në pushtet.



Përdorimi i një automjeti qeveritar për të marrë pjesë në një aktivitet të fushatës partiake.

Shembuj:



Shtyrja e hapjes së spitaleve të reja deri pak para zgjedhjeve për të fituar mbështetje elektorale.



Shtyrja e hapjes së spitaleve të reja deri pak para zgjedhjeve për të fituar mbështetje elektorale.



QYTETARË TË INFORMUAR. ZGJEDHJE TË DREJTA. DEMOKRACI E FORTË.



International Foundation
for Electoral Systems

PËR FONDACIONIN NDËRKOMBËTAR PËR SISTEMET ZGJEDHORE (IFES)

IFES promovon demokracinë për një të ardhme më të mirë. Ne bashkëpunojmë me shoqërinë civile, institucionet publike dhe sektorin privat për të ndërtuar demokraci të qëndrueshme që u shërbejnë të gjithëve. Si lider global në promovimin dhe mbrojtjen e demokracisë, përmes asistencës sonë teknike dhe kërkimit të aplikuar kontribuojmë në zhvillimin e institucioneve zgjedhore të besueshme dhe të afta për të organizuar zgjedhje kredibile; aktorëve qeverisës efektivë dhe llogaridhënës; proceseve qytetare dhe politike ku të gjithë njerëzit mund të marrin pjesë në mënyrë të sigurt dhe të barabartë; si dhe mënyrave inovative përmes të cilave teknologjia dhe të dhënat mund t'u shërbejnë pozitivisht zgjedhjeve dhe demokracisë. Që nga viti 1987, IFES ka punuar në më shumë se 145 vende, nga demokracitë në zhvillim deri te ato të konsoliduara. IFES është një organizatë globale, jopartiake, me seli në Arlington, Virginia, SHBA, dhe e regjistruar si organizatë jofitimprurëse

Që nga viti 2015, IFES ka pasur një prani të vazhdueshme në Maqedoninë e Veriut, duke bashkëpunuar me trupa zgjedhore, autoritetet publike, organizatat e shoqërisë civile, partitë politike dhe mediat për të forcuar qeverisjen demokratike dhe integritetin zgjedhor. Përmes asistencës teknike afatgjatë dhe mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve, IFES ka kontribuar në përmirësimin e administrimit të zgjedhjeve, avancimin e transparencës dhe llogaridhënies, promovimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në jetën politike dhe rritjen e besimit të qytetarëve në proceset demokratike, duke ndihmuar në ndërtimin e institucioneve demokratike më të qëndrueshme dhe më të përgjegjshme.

Për më shumë informacione rreth punës së IFES-it në Maqedoninë e Veriut, vizitoni faqen e internetit të IFES-it <https://www.ifes.org/> ose na ndiqni në <https://www.facebook.com/ifesmk/>

Mohim përgjegjësie: Ky produkt u përgatit në kuadër të projektit të Institucioneve të Qëndrueshme të Ballkanit për Qeverisje Demokratike dhe Zgjedhje (BRIDGE), i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup, dhe Programit për Mbështetjen e Zgjedhjeve të Bashkëpunimit Zviceran në Maqedoninë e Veriut, i zbatuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES). Përmbajtja e këtij produkti nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve, projekteve ose zbatuesit/zbatuesve.